

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarve N.E., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së, F.A. dhe Sh.H. për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së si dhe kundër personit juridik Kompania “.....” sh.a me seli në Ferizaj me pronar N.E. për shkak veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II. nr.1188-5/15 e datës 06.08.2015, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit N.E. dhe mbrojtësit tij me autorizim av.H.H. dhe av.A.I. i cili gjithashtu në cilësinë e pronarit të Kompanisë “.....” sh.a, të akuzuarit F.A. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.R.Sh. dhe të akuzuarit Sh.H. mbrojtësi i tij me autorizim av.J.R., pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datat 10.08.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **N.E.**, nga Shtimja, rr.”.....”, nr....., data e lindjes....., në të njëjtin vend, nga i ati I. dhe e ëma M. e gjinisë T., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion laborant, pronar i N.T.SH “.....”dhe bastore sportive “..... ..” shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal
2. **F.A.**, nga fshati komuna Shtime, data e lindjes..... në të njëjtin vend, nga i ati M. dhe e ëma S. e gjinisë H., i martuar baba i tre fëmijëve, ka të shkollën e mesme, drejtimi i veterinarisë, menaxher i dy pikave të basteve “..... Sh.a”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.personal

3. **SH.H.**, me vendbanim në Ferizaj, rr. ”.....”, data elindjes, në të njejtin vend, nga i ati B. dhe e ëma R. e gjinisë I., i martuar baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, menaxher i pikes së bastorës ”.....” në rr. ”.....”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal
4. **KOMPANIA ”.....” SH.A- si person juridik**, me seli në Ferizaj, rr. ”.....” me nr. licence 35/2013, me numër fiskal 600297750, me pronar N.E..

JANË FAJTOR

I

1. **I akuzuari N.E.**

Në kohë të pacaktuar gjerë më datë 21.07.2015, në rr.”Enver Topalli” dhe ”Naim Beka” në Ferizaj, në cilësinë e pronarit të biznesit ”..... Sh.a”, e cila merret me organizimin e lojrave të fatit, gjatë një kontrolli nga ana e Policisë NJHKEK së bashku me inspektorët e ATK-së, doganës dhe inspektorët komunal, është hasur në të dy lokalet e tij, njëra në rrugën ”Enver Topalli” menaxher i së cilës është F.A., ndërsa në lokalin tjetër në rr. ”Naim Beka” menaxher i së cilës është Sh.H., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080, pa poseduar leje përkatëse të organëve komunale dhe ATK-së duke përdorur 8 (tetë) automate të pa licencuara me nr.serik 3122000542, 3027201558, 3098300608, 3027201480, 3027201468, 30277201462, 3027201550 dhe 3027201463, të cilat iu kanë konfiskuar nga ana e policisë.

2. **I akuzuari F.A.**

Në kohë të pa caktuar gjerë më datë 21.07.2015, në rr. ”Enver Topalli” në Ferizaj, gjatë një kontrolli nga ana e Policisë NJHKEK së bashku me inspektorët e ATK-së, doganës dhe inspektorët komunal, është hasur në lokalin e lojrave të fatit ”.....”, të cilin e menaxhon i pandehuri, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit pa poseduar leje përkatëse të organeve komunale dhe ATK-së, e në kundërshtim me ligjin mbi lojrat e fatit 04/L-080,

3. I akuzuari Sh.H.

në kohë të pa caktuar gjerë më datë 21.07.2015, në rr. "Naim Beka" në Ferizaj, gjatë një kontrolli nga ana e Policisë NJHKEK së bashku me inspektorët e ATK-së, doganës dhe inspektorët komunal, është hasur në lokalitë të lojrave të fatit "..... ..", të cilin e menaxhon i pandehuri, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit pa poseduar leje përkatëse të organeve komunale dhe ATK-së, e në kundërshtim me ligjin mbi lojrat e fatit 04/L-080,

- me të cilën secili veç e veç kanë kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së.

II

1. I akuzuari F.A.

Në intervalin kohor prej 15 deri më 21.07.2015 në rr. "Enver Topalli" në Ferizaj, përkatësisht në lokalitë të lojrave të fatit "..... .." të cilin e menaxhon i pandehuri, ka dëmtuar shenjën zyrtare të vendosur nga ana e policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokali, në atë mënyrë që ka hapur objektin e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme,

2. I akuzuari Sh.H.

Në intervalin kohor prej 15 deri më 21.07.2015 në rr. "Naim Beka" në Ferizaj, përkatësisht në lokalitë të lojrave të fatit "..... .." të cilin e menaxhon i pandehuri, ka dëmtuar shenjën zyrtare të vendosur nga ana e policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokali, në atë mënyrë që ka hapur objektin e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme,

- me të cilën secili veç e veç kanë kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së.

III

Personi juridik KOMPANIA "....." S.H.A, me pronar N.E.

Në kohë të papërcaktuar deri me dt.21.07.2015, i pandehuri N.E. në cilësinë e pronarit, ndërsa të pandehurit F.A. dhe Sh.H. në cilësinë e menaxherëve të pikave të basteve, duke vepruar në emër të Kompanisë ”.....” sh.a dhe brenda autorizimeve të kësaj kompanie, me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm në emër të kësaj kompanie kanë organizuar lojëra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080 pa poseduar leje përkatëse të organeve komunale dhe ATK-së duke përdorur 8 (tetë) aparate të pa licencuara me nr.serik 3122000542, 30272201558, 3098300608, 3027201480, 3027201468, 3027201462, 3027201550 dhe 3027201463, e të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë,

-me të cilën është kryer vepra penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së lidhur me nenin 40 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 300 par.2, 414 dhe nenit 40 të KPRK-së si dhe neneve 7,17,41,42,43,46,47,69,73, të KPRK-ës, nenit 8 dhe 9 të ligjit 04/L-030 dhe nenit 233 dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarit i,

GJYKON

Të akuzuarin N.E.,

Për veprën penale sipas dispozitivit I pika 1 të këtij aktgjykimi, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3,600 (tre mijë e gjashtëqindë) Euro, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalimit në paraburgim nga data 22.07.2015 e deri më datën 10.08.2015, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPRK-së do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuajë nga një ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarin F.A.

1. Për veprën penale sipas dispozitivit I pika 2 të këtij aktgjykimi organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3, 600 (tre mijë e gjashtëqindë) Euro, ndërsa
2. Për veprën penale sipas dispozitivit II pika 1, heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumën prej 1,500 (një mijë e pesëqind) Euro.

Në kuptim të nenit 80 të KPRK-së të akuzuarin F.A. e gjykon me dënim unik me gjobë në shumën prej 5,100 (pesëmijë e njëqind) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalimit në paraburgim nga data 22.07.2015 e deri më datën 10.08.2015, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPRK-së do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuajë nga një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarin Sh.H.

1. Për veprën penale sipas dispozitivit I pika 3 të këtij aktgjykimi organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3, 600 (tre mijë e gjashtëqindë) Euro, ndërsa
2. Për veprën penale sipas dispozitivit II pika 2, heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumën prej 1,500 (një mijë e pesëqind) Euro.

Në kuptim të nenit 80 të KPRK-së të akuzuarin Sh.H. e gjykon me dënim unik me gjobë në shumën prej 5,100 (pesë mijë e njëqind) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kalimit në paraburgim nga data 22.07.2015 e deri më datën 10.08.2015, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPK-së do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuajë nga një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Personin juridik KOMPANIA "....." SH.A, me pronar N.E. për veprën penale sipas dispartitit III të këtij aktgjykimi, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë) mijë Euro.

Konform nenit 69 të KPRK-së të akuzuarve N.E., F.A. dhe Sh.H. ju shqipton dënim plotësues marrja e sendit dhe atë aparatet për lojrat e fatit me nr.serik 3122000542, 3027201558, 3098300608, 3027201480, 3027201468, 3027201462, 3027201550 dhe 3027201463 të cilat aparate do të konfiskohen nga Dogana e Kosovës.

Në bazë të nenit 367 par.1 nenpar.1.2 të KPPK-se, të pandehurve N.E., F.A. dhe Sh.H. gjykata me aktvendim të veçant iu ka ndërprerë masen e paraburgimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.II.1188-5/15 të datës 06.08.2015, ndaj të akuzuarve N.E., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së, F.A. dhe Sh.H. për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të

KPRK-së si dhe kundër personit juridik Kompania “.....” sh.a me seli në Ferizaj me pronar N.E. për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës i ka bashkangjitur:

1. Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 06.08.2015, deklaratën e të pandehurit N.E. të datës 06.08.2015 e nënshkruar nga ana e të pandehurit N.E., mbrojtësve të tij av.H.H. dhe av.A. I., prokurori i shtetit Ismet Rrahmani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Agron Qalaj.
2. Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 06.08.2015, deklaratën e të pandehurit F.A. të datës 06.08.2015 e nënshkruar nga ana e të pandehurit F.A., mbrojtësit të tij av.R.Sh., prokurori i shtetit Ismet Rrahmani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Agron Qalaj.
3. Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 06.08.2015, deklaratën e të pandehurit Sh.H. të datës 06.08.2015 e nënshkruar nga ana e të pandehurit Sh.H., mbrojtësit të tij av.J.R., prokurori i shtetit Ismet Rrahmani dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj Agron Qalaj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze me datën 10.08.2015 ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë së datës 06.08.2015, në të cilën të pandehurit, mbrojtësit e tyre dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimin të fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e këtyre marrëveshjeve sipas kushteve të përcaktuara në këto marrëveshje.

Gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas dispozitës së nenit 233 par.18 të KPPK-së, se:

- Të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
- Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar e as të shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojnë fajësinë,
- Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë nga mbrojtja e të akuzuarve gjatë procedurës hetimore, raporti i Doganës së Kosovës i dt.27.07.2015, vërtetimit mbi sekuestrimin e mallrave akcizor nr.00190 dt.27.07.2015 (ku janë sekuestruar 8

aparate për lojra fati), certifikata e numri fiskal e dt.18.12.2009, licencë nr.35/2013 e dt.11.09.2013 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës, të gjitha këto prova të siguruar gjatë procedurës hetimore.

- Si dhe nuk ekzistonë asnjë rrethanë e paraparë nga neni 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Andaj gjykata i pranoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit për të akuzuarit.

Gjykata duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit N.E. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, meqë me date, kohë dhe vend siq është përcaktuar në dispozitivin I pika 1, i akuzuari me dashje në cilësinë e pronarit të biznesit “..... sh.a” me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080 pa poseduar leje përkatëse. Po ashtu duke vlerësuar edhe aspektin juridik gjykata poashtu gjeti se në veprimet e të akuzuarit N.E. si në cilësinë e pronarit-përsosistit përgjegjës të personit juridik Kompania “.....” sh.a, me seli në Ferizaj ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, meqë në kohë, date dhe vend siq është përshkruar në dispozitivin e III të këtij aktgjykimi, i akuzuari në cilësinë e pronarit me dashje duke vepruar në emër të personit juridik Kompanisë “..... sh.a” me seli në Ferizaj dhe brenda autorizimeve të kësaj kompanie me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm në emër të kësaj kompanie kompanie ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080 pa poseduar leje përkatëse, duke përdorur aparatet e pa licencuara me nr.serik 3122000542, 30272201558, 3098300608, 3027201480, 3027201468, 3027201462, 3027201550 dhe 3027201463.

Gjykata duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit F.A. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, meqë me date, kohë dhe vend siq është përcaktuar në dispozitivin I pika 2, i akuzuari në cilësinë e menaxherit të lokalit të lojrave të fatit “..... ..” me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080. Poashtu duke vlerësuar aspektin juridik të veprimeve të akuzuarit poashtu ekzistojnë tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPK-

së, meqë me datë, kohë e vend të përshkruar si në dispozitivin e II pika 1 të këtij aktgjykimi, i akuzuari në lokalit të cilin e menaxhon “..... ..” me dashje ka dëmtuar shenjën zyrtare të vendosur nga ana e policisë dhe ATK-së me qëllim të sigurimit të atij lokali në atë mënyrë që e ka hapur lokalit e siguaruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme.

Gjykata gjithashtu duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se edhe në veprimet e të akuzuarit Sh.H. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, meqë me date, kohë dhe vend siq është përcaktuar në dispozitivin I pika 3, i akuzuari në cilësinë e menaxherit të lokalit të lojrave të fatit “..... ..” me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080. Poashtu duke vlerësuar aspektin juridik të veprimeve të akuzuarit poashtu ekzistojnë tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPK-së, meqë me datë, kohë e vend të përshkruar si në dispozitivin e II pika 2 të këtij aktgjykimi, i akuzuari në lokalit të cilin e menaxhon “..... ..” me dashje ka dëmtuar shenjën zyrtare të vendosur nga ana e policisë dhe ATK-së me qëllim të sigurimit të atij lokali në atë mënyrë që e ka hapur lokalit e siguaruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit mori se kanë arritur marrëveshje për pranimit fajësisë, sjelljen e tyre korrekte, në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmerinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe bazuar në faktin se të pandehurit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i përcaktuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Në dënimin e shqiptuar gjykata ka llogaritur kohën e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit N.E., F.A. dhe Sh.H. prej dates 22.07.2015 e deri më datën 10.08.2015 duke aplikuar dispozitën e nenit 83 par.1 të KPK-së.

Konform nenit 69 të KPRK-së të akuzuarve N.E., F.A. dhe Sh.H. ju shqiptoi dënim plotësues marrja e sendit dhe atë aparatet për lojrat e fatit me nr.serik 3122000542, 3027201558, 3098300608, 3027201480, 3027201468, 3027201462, 3027201550 dhe 3027201463, të cilat aparate janë përdorur pa licencë e të cilat aparate do të konfiskohen nga Dogana e Kosovës.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-së, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajn secili veç e veç shumën prej 30 /tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartëcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal
P.nr.940/15 të dt. 10.08.2015**

Sek.juridike
Albana Ajvazi

Gj y q t a r i,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.